



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Në mbështetje të nenit 22 të Rregullores **Nr. 01/5349/2020 të datës 31.08.2020**, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Hanit të Elezit, bënë:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE PËR VITIN 2022
Në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vlerë prej 22,000 €

KULTURË (Subvencione totale në vlerë: 3.000 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Shoqëritë Kulturore- Artistike dhe Klubet sportive (jo fitimprurëse), të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit - Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilat janë të dëshmuara për organizimin e aktiviteteve kulturore, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2022 në politikat programore të Sektorit për Kulturë.

RINI DHE SPORT (Subvencione totale në vlerë: 19.000 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Klubet Sportive Publike të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit, Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të cilat janë të dëshmuara për promovimin, zhvillimin dhe masovizimin e sportit, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e aktiviteteve (garave) të tyre për vitin 2022, në politikat programore të Sektorit për Sport.

Kërkesa për aplikim për të gjithë sektorët Kulturë, Rini dhe Sport duhet të përmbanë:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
- Projekt Propozimi bashkë me koston totale;
- Aplikacioni, (merret te Qendra për shërbim të qytetarëve);
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- Dëshmi mbi pagesën e Tatimit në pronë;
- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;

- Vërtetimi i regjistrimit pranë Federatës Përkatëse (vetëm për klubet);
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit /që përfaqëson organizatën;
- Xhirollogaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së

Data e aplikimit është nga 17.05.2022 deri 01.06.2022.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Hanit të Elezit, Qendra për shërbim të qytetarëve.

Vërejtje:

- *Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;*
- *Konkuruesit të cilët nuk kanë përmyllur avanset e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;*
- *Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen.*

**Data: 17.05.2022
Hani i Elezit**

**Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi**

